

# KOMPANI RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" Sh. A.



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C  
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD B.D  
**MITROVICA**  
TEL/FAX: 069433-787, 320-304

Nr. 696

Data: 18.04.2024

	REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E FINANCËVE - MINISTARSTVO ZA FINANCUE - MINISTRY OF FINANCE KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL
Nr./Br./No. <u>153</u>	Nrfaq./Br.faq./No.faq. _____
Data/Çesht./Date <u>18.04.2024</u>	_____
PRISHTINË-PRISHTINA-PRISHTINA	

## RAPORT VJETOR

2023

Mitrovicë, Shkurt 2024

1	RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT .....	5
1.1	Përmbledhja Ekzekutive.....	5
1.2	Aktivitetet dhe performanca e KRU "Mitrovica" .....	5
1.3	Të dhënat mbi drejtorët jo-ekzekutiv .....	5
2	RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV .....	8
2.1	Hyrje .....	8
2.2	Ngjarjet kryesore të vitit .....	9
2.3	Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës .....	9
3.3.1	<i>Rekapitulimi i inkasimit dhe shpenzimeve</i> .....	17
2.4	SHËRBIMI TEKNIK.....	21
2.5	RAPORT NGA PLANIFIKIMI & ZHVILLIMI.....	25
2.6	SHËRBIMI KOMERCIAL .....	27
2.7	INFORMIMI RAPORTIMI & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN .....	29
2.8	SHPENZIMET KAPITALE - PROJEKTET .....	31
2.9	RAPORT I SHËRBIMIT ADMINISTRATIV .....	32
2.10	PROKURIMI .....	36
2.11	Perspektiva për vitin e ardhshëm .....	37
2.12	Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet).....	38
3	SHOTJCA 1: PASQYRAT FINANCIARE .....	40
4	SHTOJCA 2 RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM.....	44
4.1	Auditimi i brendshëm .....	44

## Lista e tabelave

Tabela 1. Bordi i Drejtorëve jo – ekzekutiv .....	6
Tabela 2. Komisioni i Auditimit .....	6
Tabela 3. Aprovimi i Rregullorev/Planeve/RAPORTEVE PËR periudhën 2023 nga Bordi i Drejtorëve .....	6
Tabela 4. Mitrovicë – Indikatorët kyç të performancës .....	9
Tabela 5. Vushtrri – Indikatorët kyç të performancës.....	11
Tabela 6. Skenderaj - Indikatorët kyç të performancës .....	12
Tabela 7. KRU “Mitrovica” - Indikatorët kyç të performancës (pa veriun e Zveçanin) .....	14
Tabela 8. Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani - Indikatorët kyç të performancës .....	15
Tabela 9. KRU “Mitrovica” - Indikatorët kyç të performancës .....	15
Tabela 10. Krahasimi i indikatorëve kyç me Plan të Biznesit.....	17
Tabela 11. Inkasimi .....	17
Tabela 12. Inkasimi në euro dhe përqindje sipas kategorive .....	18
Tabela 13. Shpenzimet vjetore 2021 -2023 .....	19
Tabela 14. Shpenzimet në euro dhe përqindje.....	21
Tabela 15. Distribrimi i ujit sipas ITU-ve .....	22
Tabela 16. Krahasimi i furnizimit sipas viteve .....	22
Tabela 17. Sasia e kimikateve të shpenzuara.....	23
Tabela 18. Shpërndarja sipas njësive operative .....	24
Tabela 19. Kërkesat gjatë vitit 2023.....	26
Tabela 20. Përditësimi i të dhënave në GIS.....	26
Tabela 21. Indikatorët kyç të performancës .....	28
Tabela 22. Të dhë mbi konsumatorët paushall dhe kontratat e shërbimit dhe riprogramimit.....	29
Tabela 23. Të dhënat mbi projektin.....	31
Tabela 24. Lëvizja e punonjësve gjatë vitit 2023.....	33
Tabela 26. Strukturat e përgatitjes profesionale të punonjësve .....	34
Tabela 27. Statistika; Profesionale dhe Gjimore E KRUM –2023 Sipas Njësive .....	34
Tabela 28. Të dhënat mbi lëndët përmbartimore .....	34
Tabela 29. Të dhënat mbi lëndët sipas muajve.....	34
Tabela 30. Aktivitetet e prokurimit .....	36

## Lista e figurave

Figura 1. Inkasimi sipas viteve.....	18
Figura 2. Inkasimi sipas kategorive .....	19
Figura 3. Struktura Organizative .....	35

## Shkurtesat

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencioni Statistikor i Kosovës
BD	Bordi i Drejtorëve
CRM	Customer Relationship Management (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumator)
ITU	Impianti për Trajtimin e Ujit
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujrave të Zeza
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KRUM	Kompania Rajonale Ujësjetësi "Mitrovica"
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
SWOT	Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë, Rreziqet

# 1 RAPORTI I KRYESUESIT TË BORDIT

---

## 1.1 Përmbledhja Ekzekutive

Raportimi vjetor është obligim i kompanisë i cili buron nga Ligji Nr. 03/L-087 për ndërmarrje publike. Ky raport pasqyron performancën e arritur të kompanisë në bazë të objektivave të caktuara paraprakisht të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” (KRUM) për periudhën janar – dhjetor të vitit 2023 duke u përqendruar në prioritetet e sajë që janë furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijes dhe shërbimeve efikase për ujë dhe kanalizim.

Ky raport është i rëndësishëm në kuptimin e përmbushjes së objektivave dhe zhvillimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në kompani qoftë në aspektin financiar, po ashtu edhe në aspektin teknik, duke u përqendruar në përmbushjen e caqeve të përcaktuara me planin e biznesit për vitin 2023. Raporti që po paraqesim synon të paraqes, jo vetëm aktivitetet e kryera gjatë periudhës së raportimit por i njëjti do të shërben si udhëzues për vlerësimin e arritjeve apo ngecjeve të ndërmarrjes në rrugën e saj drejt realizimit të performancës.

Raporti përmban të dhënat e kompanisë për të gjithë sektorët e saj; prodhimin, shpërndarjen, faturimin, arkëtimin në njërin anë, po ashtu edhe shpenzimet e tërësishme të kompanisë në anën tjetër.

## 1.2 Aktivitetet dhe performanca e KRU “Mitrovica”

Gjatë vitit 2023 Kompania ka punuar në vazhdimësi për të përmbushur misionin e saj e që është furnizimi i rregullt me sasi të mjaftueshme të ujit dhe me cilësi konform standardeve për ujë të pijshëm i të gjithë konsumatorve të kyqur në rrjetin e ujësjellësit.

Duke pasur parasysh kapacitetin përpunues të Impiantëve për Trajtimin e Ujit (ITU) në Shipol dhe Balinc, kemi bërë furnizim, respektivisht shpërndarjen e balansuar të ujit të pijes nëpër komunat të cilat i furnizojmë me ujë.

## 1.3 Të dhënat mbi drejtorët jo-ekzekutiv

Në tabelën në vijim kem paraqitur të dhënat për anëtarët e bordit të drejtorëve periudhën 01.01.2023 gjerë me 31.12.2023.

Tabela 1. Bordi i Drejtorëve jo – ekzekutiv

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. i mbledhjeve prezent
1.	Kumrije Kelmendi Aliu	Kryesuese	10
2.	Zijadin Lutolli	Anëtar	9
3.	Bashkim Halabaku	Anëtar	9

Tabela 2. Komisioni i Auditimit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nr. Mbledhjeve prezent
1.	Zijadin Lutolli	Kryesues	9
2.	Bashkim Halabaku	Anëtar	9

Gjatë vitit 2023 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjithsej dhjetë (10) takime prej të cilave nëntë (9) të rregullta dhe takimin vjetor me aksionarin. Ndërsa Komisioni i Auditimit të Brendshëm ka mbajtur nga nëntë (9) takime.

Tabela 3. Aprovimi i Rregulloreve/Planeve/RAPORTEVE PËR periudhën 2023 nga Bordi i Drejtorëve

Nr.	Emri	Miratuar
1	Rregullore për procesin e blerjeve pa prokurim, si dhe ekzekutimit të pagesave me dhe pa prokurim	Miratuar
2	Rregullore për parandalimin e pirjes së duhanit në ambientet e KRU "Mitrovica," Sh. A.	Miratuar
3	Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.1347/3 për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së	Miratuar
4	Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.1347/2 mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës të KRUM-së, që të pjesa menaxheriale të përfshihen Grupet A3, A4 deri të Grupi A5 të cilët janë përfshirë në Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.1347/3 për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së	Miratuar
5	Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr.1347/3 për ndarjen e të ardhurave personale të KRUM-së.	Miratuar

6	Rregulloren për siguri dhe shendet në punë në KRU,,Mitrovica" Sh.A	Miratuar
7	Rregulloren për administrimin dhe arkivimin e dokumenteve zyrtare të KRU,, Mitrovica"Sh.A	Miratuar
8	Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale të KRU,, Mitrovica"Sh.A	
9	Plani i Biznesit për vitin 2024-2026	
10	Plani i Menaxhimit të Aseteve (PMA)	Miratuar
11	Plani i veprimit për zvogëlimin e humbjeve të ujit për vitin 2023	Miratuar
12	Plani i Veprimit për Digjitalizimin e Rrjetit Primar dhe Sekondar te Kompanisë Ujësjetësi Rajonal "Mitrovica" Sh. A	Miratuar
13	Raportin Vjetor 2022 dhe Raportin e Auditorit të Jashtëm për vitin 2022	
14	Raportet e mujore dhe tre mujore të performacës për vitin 2023	Miratuar

## 2 RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

---

### 2.1 Hyrje

Kompania Ujësjellësi Rajonal "Mitrovica" bazohet në parimet dhe funksionet bazë të saj të cilat kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe cilësore përmes ofrimit të ujit cilësor të pijes dhe mirëmbajtën e rrjetit të kanalizimit si dhe pjesërisht trajtimin e ujërave të ndotura.

Edhe këtë vit kemi qenë të përkushtuar të kontribuojmë në përmirësimin dhe ngritjen e imazhit të kompanisë me ç' rast konsumatorin e kemi pasur në qendër të vëmendjes, duke u fokusuar në përmbushjen e pritjeve të tyre prej nesh.

Raportimi është pjesë obligative për kompaninë i cili buron nga Ligji Nr.03/L-087 për ndërmarrje publike. Ky raport pasqyron performancën e arritur të kompanisë në bazë të objektivave të caktuara në Planin e Biznesit për periudhën janar – dhjetor 2023, duke u përqendruar në prioritetet e saj që janë furnizimi i qëndrueshëm me ujë të pijes dhe shërbime efikase për ujë dhe kanalizim.

Ky raport është i rëndësishëm në kuptimin e përmbushjes së objektivave dhe zhvillimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në kompani qoftë në aspektin financiar po ashtu edhe në aspektin teknik, duke punuar drejt arritjes së objektivave të caktuara me planin e biznesit për vitin 2022. Në raport kemi paraqitur arritjet e kompanisë në rrugën e saj drejt realizimit të performancës.

Në raport përfshihen të dhënat e kompanisë për sektorët:

- Prodhimit,
- Shpërndarja/distribuimi,
- Faturimi,
- Inkasimi dhe
- shpenzimet



## 2.2 Ngjarjet kryesore të vitit

Gjatë vitit të kaluar kemi kaluar nëpër shumë faza dhe dinamika të zhvillimit të cilat në këndvështrimin tonë kanë qenë sfida të vërteta pasi që planifikimi për vitin 2023ka qenë mjaft ambicioz dhe me përkushtimin e përbashkët të gjithë stafit kemi arritur një rezultat të kënaqshëm.

Ndër ngjarjet kryesore të vitit 2023 po i veçojmë disa nga më kryesoret:

- o Puna rreth digjitalizimit të rrjetit të ujësllësit & kanalizimit,
- o Nënshkrimi i kontratës me konzorciumin TEMPO –IRD – C&S (konsulenca),
- o Zgjerimi i bashkëpunimit me partner të rinjë afarist,
- o Shënimi i “22 Marsit -Ditës Botrore të Ujit”,
- o Organizmi i fushatave senzibilizuese dhe vetëdijësuese,
- o Inkuadrimi i profesionistëve të rinjë në punë praktike me pagesë,
- o Zgjerimi i bashkëpunimit me shkollat e mesme profesionale,
- o Fillimi i programit të edukimit të gjeneratave të reja mbi ujin,
- o Nënshkrimi i kontratave të bashkëpunimit me institucione arsimore akademike për t’u mundësuar studentëve të dalluar që të vijojnë praktikë profesionale në ambientet e ndërmarrjes sonë,
- o Ridizajnimi i ueb faqes zyrtare të kompanisë dhe përditësimi i të dhënave

## 2.3 Pasqyrë e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

Vitin 2023 e kemi përmbyllur me një performancë të shkëlqyeshme, pasi që kemi arritur realizimin e Planit të Biznesit në shkallë prej 96%.

Këtë rezultat e kemi arritur falë angazhimit maksimal të tërë stafit të cilët në vazhdimësi kanë treguar përkushtim dhe devotshmëri në punën e tyre. Tabela në vazhdim pasqyron rezultatet e arritura këtë vit.

Tabela 4. Mitrovicë – Indikatorët kyç të performancës

MUAI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	12,541,479	12,191,156	(350,323)	-3%
Faturimi m3	4,372,421	3,900,094	(472,327)	-11%
Faturimi nga uji €	2,341,422	2,158,600	(182,823)	-8%
Faturimi- te tjera €	19,603	32,884	13,281	68%

Faturimi Total pa TVSH€	2,361,026	2,191,484	(169,542)	-7%
Faturimi total me TVSH	2,551,500	2,370,197	(181,303)	-7%
Inkasimi nga uji €	1,942,896	2,583,905	641,009	33%
Inkasimi - te tjera €	23,213	38,764	15,551	67%
Inkasimi Total €	<b>1,966,109</b>	2,622,669	656,560	33%
Nr. i Konsumatorëve	22,272	22,650	378	2%
% e inkasimit	77%	111%	0	44%
Shpenzimet	<b>2,065,767</b>	2,303,168	237,401	11%
Pagat	1,034,981	1,159,237	124,256	12%
Rryma elektrike	447,984	480,053	32,069	7%
Shpe. e derivateve	22,908	21,606	(1,302)	-6%
Miremb. Dhe riparimet	32,465	51,677	19,212	59%
Kemikalet	54,874	88,249	33,375	61%
Shp. - lber Lepenci	356,588	352,125	(4,463)	-1%
Shpenzimet tjera	115,968	150,221	34,253	30%
Uji I pafaturuar në m3	8,169,058	8,291,062	122,004	1%
Uji I pafaturuar ne %	65%	68%	0	4%
Mbulimi operativ	<b>95%</b>	<b>114%</b>	0	20%

Nga tabela më lartë shihet se nga sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar, Mitrovicës i janë shpërndarë 12,191,156m<sup>3</sup> nga e cila sasi kemi faturuar 3,900,094m<sup>3</sup> apo shprehur në përqindje 32% e sasisë së shpërndarë janë faturuar kurse pjesa tjetër prej 8,291,062 m<sup>3</sup> apo 68% mbetet si sasi e pa faturuar e ujit e cila llogaritet të jetë humbje teknike (rrjedhje nëntokësore, rrjeti i vjetruar që nuk garanton cilësi, pamundësia e intervenimit në kohë etj.) apo komerciale që nënkupton keqpërdorimin e ujit nga konsumatorët tanë.

Faturimi për Mitrovicë për vitin 2023 arrin vlerën në total 2,370,197€, nga të cilat 2,158,600€ janë nga shërbimet bazë të ujit, ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 32,884€ është nga të hyrat tjera; kyçje dhe legalizime.

Ndërsa Inkasimi nga shitja e ujit gjatë vitit 2023 ka arritur vlerën prej 2,622,669€ apo shprehur në përqindje arrin shkallën prej 111% e ujit të faturuar.

Shpenzimet operative për Mitrovice arrijnë vlerën prej 2,303,168€ që rezulton me një mbulim operativ prej 114%.

Ndërsa humbjet ujit janë ende të larta (68%) dhe ky mbetet një problem i cili duhet të trajtohet me prioritet në vazhdim e sipër. Faturimi është realizuar në shkallën prej 87.4% nga plani i biznesit, inkasimi po ashtu është realizuar në shkallën prej 96.13% nga plani. Numri i konsumatorëve në vitin 2023 ka pasur rritje për 2% krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 5. Vushtrri – Indikatorët kyç të performancës

MUAI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	7,240,885	7,275,610	34,725	0%
Faturimi m3	2,879,008	2,939,864	60,855	2%
Faturimi nga uji €	1,415,989	1,464,768	48,780	3%
Faturimi- te tjera €	8,310	6,529	(1,780)	-21%
Faturimi Total pa TVSH€	1,424,298	1,471,298	46,999	3%
Faturimi total me TVSH	1,534,477	1,585,118	50,641	3%
Inkasimi nga uji €	1,230,507	1,505,225	274,718	22%
Inkasimi - te tjera €	9,991	7,670	(2,321)	-23%
Inkasimi Total €	1,240,499	1,512,894	272,395	22%
Nr. i Konsumatorëve	16,898	17,879	981	6%
% e inkasimit	81%	95%	0	18%
Shpenzimet	1,039,786	1,160,424	120,638	12%
Pagat	607,697	654,114	46,417	8%
Rryma elektrike	186,573	202,402	15,829	8%
Shpe. e derivateveve	9,527	8,577	(950)	-10%
Miremb. Dhe riparimet	7,534	9,412	1,878	25%
Kemikalet	21,306	58,336	37,030	174%
Shp. - Iber Lepenci	144,857	151,136	6,279	4%

Shpenzimet tjera	62,292	76,447	14,155	23%
Uji I pafaturuar në m3	4,361,877	4,335,746	(26,130)	-1%
Uji I pafaturuar ne %	60%	60%	(0)	-1%
Mbulimi operativ	119.3%	130%	0	9%

Nga tabela e mësipërme shihet se gjatë vitit 2023 nga sasia e përgjithshme e ujit të prodhuar për Vushtrri janë shpërndarë 7,275,610m<sup>3</sup> nga e cila sasi janë faturuar 2,939,864m<sup>3</sup> apo 40% e sasisë së prodhuar është faturuar, ndërsa pjesa prej 4,335,746 m<sup>3</sup> apo 60% paraqet ujin e pa faturuar e cila llogaritet të jetë humbje teknike (rrjedhje nëntokësore, rrjeti i vjetruar që nuk garanton cilësi, pamundësia e intervenimit në kohë etj.) apo komerciale që nënkupton keqpërdorimin e ujit nga konsumatorët tanë.

Shihet po ashtu se kemi rritje të prodhimit të ujit prej 34,725m<sup>3</sup> e cila ka ardhur si rezultat i menaxhimit efikas të prodhimit dhe shpërndarjes përkundër faktit që kemi pasur rritje të numrit të konsumatorëve për 6%.

Faturimi i ujit për vitin 2023 për Vushtrri arrin vlerën monetare prej 1,585,118€ prej së cilës shumë 1,464,768€ paraqesin sasinë e faturuar për shërbimet bazë të ujit.

Ndërsa inkasimi për Vushtrri për vitin 2023 arrin shumën e përgjithshme në vlerë prej 1,512,894€, nga te cilat 1,505,225€ janë inkasim nga uji, ndërsa pjesë e mbetur prej 10.669€ janë të hyra nga shërbimet. Nëse e shohim si përqindje, atëherë del se 95% e faturimit është inkasuar.

Shpenzimet operative për njësinë Vushtrri arrijnë vlerën prej 1,160,424, që rezulton me një mbulim operativ prej 130%.

Nëse krahasojmë indikatorët kyç të performancës me planin e biznesit, Vushtrria ka shpërndarë 21.3% ujë më tepër sesa plani i biznesit apo shprehur në sasi 1.275.610m<sup>3</sup>. Nga ana tjetër humbjet e ujit kanë mbetur në shkallën e njëjtë prej 60% që nënkupton se në këtë drejtim duhet bërë përpjekje të vazhdueshme për të reduktuar këtë nivel të lartë të humbjeve.

Faturimi është realizuar në shkallën prej 93% në krahasim me planin e biznesit. Numri i konsumatorëve po ashtu ka pësuar rritje dhe tejkalim për 6%.

Tabela 6. Skenderaj - Indikatorët kyç të performancës

MUAI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	2,906,000	2,720,600	(185,400)	-6%
Faturimi m3	1,021,397	947,675	(73,722)	-7%
Faturimi nga uji €	558,110	543,032	(15,078)	-3%
Faturimi- te tjera €	12,606	11,644	(962)	-8%
Faturimi Total pa TVSH€	570,716	554,676	(16,040)	-3%
Faturimi total me TVSH	617,640	600,292	(17,348)	-3%
Inkasimi nga uji €	518,180	654,178	135,998	26%
Inkasimi - te tjera €	13,043	13,527	484	4%
Inkasimi Total €	531,223	667,705	136,482	26%
Nr. i Konsumatorëve	8,648	9,196	548	6%
% e inkasimit	86%	111%	0	29%
Shpenzimet	553,258	591,422	38,164	7%
Pagat	356,689	383,053	26,364	7%
Rryma elektrike	87,476	87,750	274	0%
Shpe. e derivateve	5,972	5,236	(736)	-12%
Mirëmbajtja& riparimet	3,778	5,667	1,889	50%
Kemikatet	9,683	15,573	5,890	61%
Iber Lepenci	62,927	62,140	(787)	-1%
Shpenzimet tjera	26,733	32,003	5,270	20%
Uji l pa faturuar në m3	1,884,603	1,772,925	(111,678)	-6%
Uji l pa faturuar ne %	65%	65%	0	0%
Mbulimi operativ	96%	113%	0	18%

Nga sasia e përgjithshme e sasisë së ujit të prodhuar për vitin 2023, për Skenderaj janë shpërndarë 2,720,600 m3 prej së cilës sasi 947,675 m3 apo 35% janë faturuar ndërsa sasia e pa faturuar prej 1,772.925m3 apo 65% paraqet sasinë e pa faturuar të ujit nga uji i shpërndarë e cila llogaritet të jetë humbje teknike (rrjedhje nëntokësore, rrjeti i vjetruar që nuk garanton cilësi, pamundësia e intervenimit në kohë etj.) apo komerciale që nënkupton keqpërdorimin e ujit nga konsumatorët tanë. Shihet po ashtu se kemi pasur rënje të ujit të shpërndarë në shkallë prej 6% ose 185.400m3, pavarësisht rritjes së numrit të konsumatorëve prej 6% krahasuar me vitin paraprak dhe pa u dëmtuar cilësia e shërbimit ndaj tyre. Kjo nënkupton menaxhim të mirëfilltë të

rrjetit përmes evidentimit të konsumatorëve ilegal, humbjeve komerciale të pa arsyeshme dhe me një mirëmbajtje më të mirë të humbjeve teknike. Faturimi ka pësuar një rënie të lehtë në raport me vitin paraprak në vlerë prej 17.348€ ose 3%. Inkasimi ka pësuar po ashtu rritje në raport me vitin paraprak në shkallë prej 26 % apo në vlerë monetare 136,482€.

Faturimi në vlerë monetare për njësinë operative të Skenderajt për vitin 2023 arrijnë vlerën e përgjithshme prej 600,292€, nga të cilat 543,032€ paraqet faturimin për shërbimet bazë të ujit.

Njësia operative e Skenderajt gjatë vitit 2023 ka arritur të inkasoj mjete monetare në vlerë prej 667,705€ apo 111% e mjeteve të faturuara, janë inkasuar.

Nga ana tjetër shpenzimet operative të njësisë operative në Skenderaj arrijnë vlerën prej 591,442€ që rezulton me një mbulim operativ prej 113%.

Nëse krahasojmë indikatorët kyç të performancës me planin e biznesit, Skenderaj ka shpërndarë 24% ujë më pak sesa plani i biznesit apo shprehur në sasi 879.400m<sup>3</sup>. Niveli i ujit të pa faturuar kam mbetur në shkallë të njëjte prej 65% në raport me ujin e shpërndarë. Kemi pasur rritje të numrit të konsumatorëve prej 6% në krahasim me vitin paraprak.

Tabela 7. KRU "Mitrovica" - Indikatorët kyç të performancës (pa veriun e Zveçanin)

MUAJI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m <sup>3</sup>	22,688,364	22,187,366	(500,998)	-2%
Faturimi m <sup>3</sup>	8,272,827	7,787,633	(485,194)	-6%
Faturimi nga uji €	4,315,520	4,166,400	(149,121)	-3%
Faturimi- te tjera €	40,519	51,058	10,539	26%
Faturimi Total pa TVSH€	4,356,040	4,217,458	(138,582)	-3%
Faturimi total me TVSH	4,703,617	4,555,607	(148,010)	-3%
Inkasimi nga uji €	3,691,583	4,743,308	1,051,725	28%
Inkasimi - te tjera €	46,247	59,961	13,714	30%
Inkasimi Total €	3,737,830	4,803,269	1,065,439	29%
Nr. i Konsumatorëve	47,818	49,725	1,907	4%
% e inkasimit	79%	105%	0	33%
Shpenzimet	3,658,812	4,055,014	396,202	11%

Pagat	1,999,367	2,196,404	197,037	10%
Rryma elektrike	722,033	770,205	48,172	7%
Derivatet	38,407	35,419	(2,988)	-8%
Mirëmbajtja & riparimet	43,777	66,756	22,979	52%
Kimikatet	85,863	162,158	76,295	89%
Ibër Lepenci	564,372	565,401	1,029	0%
Shpenzimet tjera	204,993	258,671	53,678	26%
Uji I pa faturuar në m3	14,415,537	14,399,733	(15,804)	0%
Uji I pa faturuar ne %	64%	65%	0	2%
Mbulimi operativ	102%	118%	0	16%

Në tabelën e mësipërme mund të shihen rezultatet financiare të indikatorëve kyç por pa e përfshirë Veriun. Mbulimi operativ për vitin 2023 arrin 118%.

Tabela 8. Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani - Indikatorët kyç të performancës

MUAI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	4,610,144	4,915,774	305,630.00	7%
Faturimi m3	4,610,152	4,885,774	275,622.00	6%
Faturimi nga uji €	783,822	830,677	46,855.30	6%
Faturimi Total pa TVSH€	783,822	830,676	46,854.60	6%
Faturimi total me TVSH	846,528	897,132	50,603.79	6%

Tabela më lartë pasqyron të dhënat për veriun e Mitrovicës ku shihet se 4,915,774 m3 ujë me shumicë janë shpërndarë dhe sasia e njëjtë është faturuar për veriun e Mitrovicës.

E tërë sasia e shpërndarë për veri llogaritet si shitje me shumicë e ujit të pijes dhe vlera totale e ujit të faturuar për atë pjesë kap shumën prej 897,123€.

KRU "Mitrovica" në veri bënë vetëm shpërndarjen e ujit me shumicë por jo edhe menaxhimin apo mirëmbajtjen e rrjetit qoftë të ujit apo kanalizimit.

Tabela 9. KRU "Mitrovica" - Indikatorët kyç të performancës

MUAI	2022	2023	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
Prodhimi m3	27,298,508	27,103,140	(195,368)	-1%

Faturimi m3	12,896,070	12,673,407	(222,663)	-2%
Faturimi nga uji €	5,099,342	4,997,077	(102,266)	-2%
Faturimi- te tjera €	40,519	51,058	10,539	26%
Faturimi Total pa TVSH€	5,139,862	5,048,135	(91,727)	-2%
Faturimi total me TVSH	5,550,145	5,452,739	(97,406)	-2%
Inkasimi nga uji €	3,691,583	4,743,308	1,051,725	28%
Inkasimi - te tjera €	46,247	59,961	13,714	30%
Inkasimi Total €	3,737,830	4,803,269	1,065,439	29%
Nr. i Konsumatorëve	47,822	49,729	1,907	4%
% e inkasimit	67%	88%		
Shpenzimet	3,658,812	4,055,014	396,202	11%
Pagat	1,999,367	2,196,404	197,037	10%
Rryma elektrike	722,033	770,205	48,172	7%
Derivatet	38,407	35,419	(2,988)	-8%
Mirëmbajta & riparimet	43,777	66,756	22,979	52%
Kimikatet	85,863	162,158	76,295	89%
Ibër Lepenci	564,372	565,401	1,029	0%
Shpenzimet tjera	204,993	258,671	53,678	26%
Uji i pa faturuar në m3	14,402,438	14,429,733	27,295	0%
Uji i pa faturuar ne %	53%	53%		
Mbulimi operativ	102%	118%		

Nga tabela më lartë shihet se KRU "Mitrovica" për periudhën Janar-Dhjetor 2023 ka prodhuar 27,103,140 m3, ujë të pijes kurse 12,673,407 m3 apo 47% janë faturuar. Nga kjo shihet se shkalla e ujit të pa faturuar ishte 53% ose 14,429,733m3 ujë të pijes.

Vlera monetare e faturuar për vitin raportues ishte 5,452,739€ prej të cilave 4,997,077€ paraqesin faturimin për shërbimet bazë të ujit.



Gjatë vitit 2023 kemi arritur të inkasojmë 4,803,269€, nga të cilat 4,743,308€ janë inkasuar vetëm nga uji. Nëse e shohim si përqindje, atëherë del se 88% e faturimit është inkasuar.

Shpenzimet operative arrijnë vlerën prej 4,055,014€ që rezulton me një mbulim operativ prej 118%.

Në bazë të indikatorëve të paraqitur në tabelën më lartë, sasia e ujit të prodhuar ka pasur një rënje të lehtë prej 1% krahasuar me vitin paraprak. Nga ana tjetër faturimi i sasisë së ujit ka pasur një zbritje prej 2% në krahasim me vitin paraprak. Ndërsa inkasimi për vitin aktual është rritur për 29% krahasuar me vitin paraprak. Numri i konsumatorëve po ashtu është rritur për 4%. Kurse tek shpenzimet kemi pasur një rritje prej 11% në krahasim me vitin paraprak.

Tabela 10. Krahasimi i indikatorëve kyç me Plan të Biznesit

	Realizimi 2023	Plani I Biznesit 2023	Realizimi
Furnizimi me ujë	27,103,140	25,000,000	108%
Humbjet e ujit	53%	52%	
Faturimi €	5,392,497	6,172,929	87%
Inkasimi €	4,743,344	4,934,460	96%
Nr. i konsumatorëve	49,729	48,614	102%

### 3.3.1 Rekapitulimi i inkasimit dhe shpenzimeve

Tabela 11. Inkasimi

Nr	Përshkrimi	Mitrovicë	Vushtrri	Skenderaj	Gjithsej	Inkasimi Total
1	Amvisni	1,810,868	1,210,809	475,252	3,496,929	3,496,929
2	Biznes	353,486	124,426	113,595	591,507	591,507
3	Ekonomi	215,459	-	234	215,693	215,693
4	Institucionet	195,532	109,260	65,097	369,889	369,889
5	Ndërkombtaret	8,561	60,729	-	69,290	69,290
	<b>TOTALI 1</b>	<b>2,583,905</b>	<b>1,505,225</b>	<b>654,178</b>	<b>4,743,308</b>	<b>4,743,308</b>
6	Zyra për Komunitete VERI				-	-
7	Sherbimet 18%	431	192	433	1,055	1,055
8	Shitja e skrapit	25,306			25,306	25,306
	Kyqjet 18%	13,027	7,478	13,094	33,600	33,600
	<b>TOTALI 2</b>	<b>2,597,363</b>	<b>1,512,894</b>	<b>667,705</b>	<b>4,777,963</b>	<b>4,803,269</b>

Subvencionet					-	-
Gjithsejt	2,597,363	1,512,894	667,705	4,777,963	4,803,269	




Figura 1. Inkasimi sipas viteve

### 2.3.2 Inkasimi në bazë të kategorive

Tabela 12. Inkasimi në euro dhe përqindje sipas kategorive

Kategoria	Inkasimi	%
Amvisni	3,496,929	74%
Biznes	591,507	12%
Institucionet	585,582	12%
Ndërkombtaret	69,290	1%
TOTALI	4,743,308	100%

Nga tabela më lartë shihet se 74% e inkasimit mbulohet nga amvisëria, 12% mbulohen nga bizneset, 12% nga Institucionet dhe 1% nga kategoria e ndërkombëtarëve. Të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë po i paraqesim edhe në mënyrë grafike.

Kjo mund të shihet edhe përmes grafit në vijim.




Figura 2. Inkasimi sipas kategorive

### 2.3.3 Shpenzimet

Në vazhdim kemi paraqitur shpenzimet vjetore të ndara sipas kategorive dhe njësive operative.

Tabela 13. Shpenzimet vjetore 2021 -2023

Përshkrimi i shpenzimit	2021	2022	2023	2021/2023	2022/2023
				%	%
Uji i blerë me shumicë	465,068	564,371	565,402	22%	0%
Energjia elektrike	722,583	722,032	770,205	7%	7%
Karburanti	22,437	38,406	35,419	58%	-8%
Lëndë djegëse	1,047	1,675		-100%	-100%
Pagat e punëtorëve	1,877,370	1,987,008	2,196,404	17%	11%
Pagat e bordit	20,328	11,474	16,128	-21%	41%
Pagat për pension					
Ushqimi i punëtorëve	128	445		-100%	-100%
Shpenzimet materiale	16,248	16,270	44,120	172%	171%
Material për higjienë	972	2,123	2,553	163%	20%
Rroba mbrojtëse ne punë	159	1,474	766	382%	-48%
Analizat e ujit	6,685	9,468	11,378	70%	20%
Kemikatet	45,712	85,863	162,159	255%	89%

Transporti i mall. & shërb.		1,774			-100%
Telefonia mobile	4,798	7,295	8,537	78%	17%
ARU Licenca	33,697	39,169	41,726	24%	7%
Tatimi në pronë	1,694	4,394	796	-53%	-82%
Taksa Gjyqësore		1,020			-100%
Shukosi	6,760	10,700	11,172	65%	4%
Internet	1,756	1,806	1,712	-3%	-5%
Bartja e mbeturinave	481	704	197	-59%	-72%
Pjesmarrja në konferenca		1,500	6,079		305%
Qiraja	18,462	17,363	17,055	-8%	-2%
Sigurimi i automjeteve	5,879	7,324		-100%	-100%
Dizajnimi i projekteve	294			-100%	
Anëtarësimi	5,904	414		-100%	-100%
Kamatat	98,462	19,157	9,044	-91%	-53%
Përmbaruesi	63,879	46,113	43,124	-32%	-6%
Auditimi	2,424	1,850		-100%	-100%
Konkurset	836	1,829	2,840	240%	55%
Reprezentacion	1,829	5,233	12,155	565%	132%
Byfe	287	915	1081	277%	18%
Udhëtim zyrtar	218	500	7075	3145%	1315%
Dhurata		115			-100%
Reklama	3,422			-100%	
Provizion Bankar	2,293	5,247	7,198	214%	37%
Rekreacion për punonjës		880			-100%
Mirëmbajtje	29,583	44,140		-100%	-100%
Demtimi i tokës	2,546	1,063		-100%	-100%
Borgji i keq	1,783,386	659,456	320,356	-82%	-51%
Shpenzimet tjera		697	80,689		11477%
<b>Totali</b>	<b>5,247,627</b>	<b>4,318,267</b>	<b>4,375,370</b>		

Nëse i analizojmë shpenzimet, pjesën më të madhe e marrin pagat e punonjësve të cilat përfshijnë 55% të shpenzimeve të vitit 2023 , pastaj 19% të shpenzimeve përfshijnë shpenzimet për energji elektrike, 14% për Iber Lepencin (uji i patrajtur), 4% për Kimikate etj.

Sa i përket pagave gjate vitit 2023 kemi pasur një rritje mesatare prej 6% po ashtu kemi ngritur pagesën për shujta nga 2€ në 3€ për person e cila po ashtu ka pasur efekt në shpenzimet e përgjithshme. Edhe shpenzimet e energjisë elektrike kane pësuar rritje si pasoje e ngritjes se tarifave te energjisë elektrike. Karburantet janë stabilizuar si pasoje e çmimit te vendosur nga qeveria e Kosovës, prandaj kjo ka reflektuar me zvogëlim të shpenzimeve të karburanteve.

Tabela 14. Shpenzimet në euro dhe përqindje

Shpenzimet	€	%
Pagat	2,212,532	55%
Energjia elektrike	770,205	19%
Iber Lepenci	565,402	14%
Kemikalet	162,159	4%
Derivatet	35,419	1%
ARRU	41,726	1%
Shp. e perfaqesimit Ligjor	43,124	1%
Mirembajtje	66,757	2%
Te tjera	157,690	4%
Total	4,055,014	100%

## 2.4 SHËRBIMI TEKNIK

### 2.4.2 Prodhimi

Gjatë vitit 2023 janë prodhuar, respektivisht shpërndarë 27,103.140 m<sup>3</sup> që nëse krahasohet me vitin e kaluar del që kemi prodhuar 195,268 m<sup>3</sup> më pak edhe përkundër pranimit të rrjeteve të reja të ujësjellësit dhe shtimit të numrit të konsumatorëve. Pra, kemi arritur që në nivel rajonal të prodhojmë më pak ujë sesa vitin paraprak. Ky ka qenë një nga objektivat tanë kryesorë drejt zvogëlimit të prodhimit i cili objektivi do të vazhdojë të realizohet edhe në vitet në vijim. Gjatë vitit 2023, nga ITU në Shipol janë shpërndarë 19,827,530 m<sup>3</sup>, ndërsa ITU Balinc 7,275,610 m<sup>3</sup> ujë të pijes.

Departamenti Teknik me masat e ndërmarrë mbi rrjedhjet në rrjete, puseta dhe rezervuar të cilat janë raportuar nga konsumatorët apo zbuluar nga punëtorët e kompanisë janë sanuar brenda një kohe të shkurtër dhe e cila ka ndikuar në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Tabela 15. Distribuimi i ujit sipas ITU-ve

Uji i prodhuar- ITU	Shipol m <sup>3</sup>	Balince m <sup>3</sup>	Totali m <sup>3</sup>
Janar	1,452,753	533,171	1,985,924
Shkurt	1,424,388	546,780	1,971,168
Mars	1,563,831	560,694	2,124,525
Prill	1,628,294	563,568	2,191,862
Maj	1,639,666	586,976	2,226,642
Qershor	1,609,113	574,160	2,183,273
Korrik	1,824,794	717,118	2,541,912
Gusht	1,868,172	716,649	2,584,821
Shtator	1,767,485	656,046	2,423,531
Tetor	1,698,660	622,261	2,320,921
Nentor	1,610,836	578,144	2,188,980
Dhjetor	1,739,538	620,043	2,359,581
<b>Totali</b>	<b>19,827,530</b>	<b>7,275,610</b>	<b>27,103,140</b>

Tabela 16. Krahasimi i furnizimit sipas viteve

Uji i prodhuar ITU-të	Viti 2023 m <sup>3</sup>	Viti 2022 m <sup>3</sup>	Diferenca m <sup>3</sup> 2023/2022
Janar	1,985,924	2,334,438	-348,514
Shkurt	1,971,168	2,084,692	-113,524
Mars	2,124,525	2,298,949	-174,424
Prill	2,191,862	2,217,304	-25,442
Maj	2,226,642	2,377,959	-151,317
Qershor	2,183,273	2,359,564	-176,291
Korrik	2,541,912	2,567,218	-25,306
Gusht	2,584,821	2,433,872	150,949
Shtator	2,423,531	2,178,167	245,364
Tetori	2,320,921	2,259,912	61,009
Nëntori	2,188,980	2,008,093	180,887
Dhjetori	2,359,581	2,178,240	181,341
<b>Totali</b>	<b>27,103,140</b>	<b>27,298,408</b>	<b>- 195,268</b>

### 2.4.3 Cilësia e ujit

Në laboratorin e ITU në Shipol për monitorimin e cilësisë të ujit janë bërë matjet e parametrave fiziko-kimik për 1,800 mostra, kurse në laboratorin e ITU Balinc janë bërë 2163 mostra për matje e parametrave: Temperatura, Era, Shija, NTU, pH,  $\text{KmNO}_4$ ,  $\text{Cl}_2$ , Kloruret,  $\text{NH}_3$ , Nitratet, Nitritet, Përçueshmëria, Fe. IKSHP në kushte normale ka bërë testimin e një mostre të ujit brenda javës për matje të parametrave fiziko-kimik dhe mikrobiologjik. IKSHP po ashtu bënë monitorimin e cilësisë së ujit në bazë të kontratës së rregullt mbi parametrat e ujit të pijes.

Monitorimi i cilësisë të ujit është bërë sipas planit të përputhshmërisë dhe planit të jashtëm.

Rezultatet e analizave për matje të parametrave në laboratorët e Impianteve në Shipol, Balinc dhe rezultatet e IKSHP kanë treguar se uji i trajtuar në Impiantet tona ka qenë në përputhje me standardet për ujë të pijshëm sipas UA 10/2021.

### 2.4.4 Kimikatet

Gjate vitit 2023 për trajtim të ujit të pa përpunuar si koagulant kemi përdorur kloruriferrik dhe sulfatin e sluminit, ndërsa si dezinfektues klorin e gaztë në të dy Impiantet.

Siç shihet në tabelën më poshtë, kemi shpenzuar 16,928 kg sulfat alumini, 37,059 kg klor i gaztë dhe 178,426 kg koagulant Klorur ferrik. Sasia e rritur e klorurit ferrik ka ardhur si pasojë e turbullshmërisë së madhe e cila ka mbizotëruar gjate vërshimeve në fillim të vitit 2023.

**Tabela 17. Sasia e kimikateve të shpenzuara**

Muaji	Shipol	Balinc	Shipol	Balinc	Shipol	Balinc	Shipol	Balinc
	Alumin sulfati –kg		Polielektroliti kg		Klori gaz kg		Kloruriferrik kg	
Janar	200	1,083	-	10	2,000	1,011	26,400	6,080
Shkurt	6,000	5,245	75	25	1,900	705	-	1,288
Mars	4,400	-	-	-	2,015	801	3,700	6,373
Prill	-	-	-	-	2,100	854	6,600	6,720
Maj	-	-	-	-	2,200	928	7,500	7,859
Qershor	-	-	-	-	2,310	883	12,800	1,334
Korrik	-	-	-	-	2,750	962	4,510	5,824
Gusht	0	0	0	0	2,405	970	5,280	2,744
Shtator	0	0	0	0	2,371	1,111	4,970	1,960
Tetori	0	0	0	0	2,500	1,072	4,764	1,904

Nëntori	0	0	0	3	2,349	902	14,652	14,200
Dhjetor	0	0	0	0	1,960	1,065	16,600	14,364
Totali	10,600	6,328	75	38	26,860	10,199	107,776	70,650
Gjithsej;	16,928		113		37,059		178,426	

#### 2.4.5 Sektori i elektro – makinerisë

Gjatë vitit 2023 mirëmbajtja elektro - makinerisë evitoj të gjitha defektet në Stacionet e pompimi dhe ITU-të . Në këtë vit u lubrifikuan dhe ndërruan gjitha kushinetat të cilat kishin kaluar orët e punës të parapara nga prodhuesi. Po ashtu u intervenua shumë herë në evitim të defekteve në aparaturën e klorit pasi siç dihet në këtë vit ka pasur shumë probleme me aparaturën e klorit. Në Stacione pompimi u ndërruan pompa dhe u vendosën pompa të reja si në: Stacionin e pompimit Kçiç, Koshtovë, Vërrnicë dhe Bistricë.

#### 2.4.6 ITUZ në Skenderaj

Gjate vitit 2023 janë raportuar se janë trajtuar 861,021 m<sup>3</sup> ujëra të zeza. Ne laboratorin e impiantit janë marrë 48 mostra dhe janë analizuar nga nëntë (9) parametra, nga secila mostër. Pas trajtimit të ujërave të ndotura, të njëjtat i kanë plotësuar kriteret për tu shkarkuar në lum.

#### 2.4.7 Raporti i Njësive Operative

Gjatë vitit 2023 shpërndarja e ujit të pijes nga ITU Shipol në sasi prej 19,827530 m<sup>3</sup>, është shpërndarë si vijon: 61.4 % për Mitrovicën Jugore, 13.7 % për Skenderaj dhe 24.7 % për Veriun e Mitrovicës. Ndërsa ITU Balinc ka furnizuar 100% komunën e Vushtrrisë.

Tabela 18. Shpërndarja sipas njësive operative

Qyteti	Mitrovica	Vushtrri	Skenderaj	Mitrovica	Totali
Muaj	Jugore			Veriore	
Janar	875,731	533,171	189,600	387,422	1,985,924
Shkurt	863,440	546,780	188,200	372,748	1,971,168
Mars	907,441	560,694	198,400	457,990	2,124,525
Prill	1,006,184	563,568	219,400	402,710	2,191,862
Maj	1,003,246	586,976	210,800	425,620	2,226,642
Qershor	985,887	574,160	210,000	413,226	2,183,273
Korrik	1,149,435	717,118	235,000	440,359	2,541,912
Gusht	1,223,392	716,649	259,000	385,780	2,584,821
Shtator	1,143,618	656,046	240,900	382,967	2,423,531
Tetor	1,060,571	622,261	245,300	392,789	2,320,921
Nëntori	953,493	578,144	259,000	398,343	2,188,980



Dhjetori	1,018,718	620,043	265,000	455,820	2,359,581
<b>Totali</b>	<b>12,191,156</b>	<b>7,275,610</b>	<b>2,720,600</b>	<b>4,915,774</b>	<b>27,103,140</b>

Në të tri njësitë operative; Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj, kanë pranuar 3,453 ankesa, prej të cilave 2,184 ankesa kanë qenë për rrjetin e ujit dhe 1,369 ankesa kanë qenë për rrjetin e kanalizimit. Ankesat kanë qenë për mirëmbajtje të rrjetit të ujit si: ndërrim i gypit, rrjedhje, montim të ujëmatësve, riparim të ujëmatësve, kyçje të reja, hulumtim të rrjeti për shkak të rrjedhjeve të pa dukshme, riparime të valvuleve si edhe mirëmbajtje te rrjetit te kanalizimit dhe pastrim i rrjetit.

Njësitë Operative, gjatë tërë vitit, kanë qenë aktive në mirëmbajtjen dhe riparimin e rrjetit të ujit dhe në parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijes. Ankesat dhe kërkesat janë shqyrtuar në vazhdimësi dhe në kohën optimale.

#### *2.4.8 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve*

Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve ka kryer aktivitetet të cilat kanë ndikuar në mbarëvajtjen e aktiviteteve ditore të njërive operative: në kontrollimin, servisimin, regjistrimin dhe funksionalizimin e automjeteve.

## **2.5 RAPORT NGA PLANIFIKIMI & ZHVILLIMI**

Gjatë vitit 2023 është intensifikuar puna rreth digjitalizimit të rrjetit të ujit dhe kanalizimit duke përfshirë impiantet, e rezervuarët, stacionet e pompimit dhe konsumatorët.

Ky aktivitet na ka ndihmuar në punët tona të përditshme dhe ka shtuar:

- Efikasitetin dhe efektivitetin në punë.
- Monitorimin e rrjedhjes së ujit dhe përpunimin e të dhënave të ndryshme statistikore dhe planifikimin e intervenimeve dhe të ndërrimit në rrjet sipas vjetërsisë së tubacionit.
- Vlerësimin e përgjithshëm të aseteve.

Gjatë muajit maj është organizuar punëtorja pesë ditore për trajtimin e humbjeve të ujit nga ekspertët e TAIEK, ku kemi marrë pjesë dhe kemi përfituar njohuri në menaxhimin e humbjeve të ujit.

Takimi i thirrur nga ARRU i mbajtur në KRU" Mitrovica" në zyrën e Sektorit GIS, për njoftimin për së afërmi rreth progresit të Planit të menaxhimit.

Takim me menaxherët e Nj.O. Mitrovicë, Vushtrri, Skënderaj, menaxherin e aseteve dhe KE, lidhur me përfundimin e draft Raportit për Planin e Menaxhimit të Aseteve, paraqitja e të dhënave të kërkuara nga ARRU.

Është punuar në lidhjen e konsumatorve me Gis-in, me çrast kemi arritur që në baza kadastrale, rajonale e më gjerë të identifikojmë borxhlinjë dhe zonat me inkasim më të dobët, hartë kjo e cila do të shërbejë si kontrollës ashtu edhe drejtorisë komerciale për analiza.

Kemi pranuar shumë kërkesa, rreth kyçjeve, rrjedhjeve, legalizimeve, pëlqimve, etj., të cilat i kemi trajtuar me kohë dhe të njëjtat po i pasqyrojmë më poshtë:

Tabela 19. Kërkesat gjatë vitit 2023

Nr.	Përshkrimi i kërkesave	Viti 2023												total
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	
1	Kërkesa të pranuar	59	40	45	50	60	68	73	106	132	133	147	145	1018
2	Kërkesa të shqyrtuara	48	40	40	48	30	62	68	103	130	128	144	142	984
3	Kërkesa për Kyçje	4	1	4	5	1	3	5	6	8	9	1	2	49
4	Kërkesa për Ri - Kyçje	0	0	0	0	0	1	1	0	0	2	0	0	4
5	Kërkesa për Legalizim	14	25	21	12	10	11	12	67	43	45	57	48	365
6	Kërkesa për banesa	2	1	2	1	2	2	2	1	0	2	1	1	17
7	Kërkesa për pëlqime	1	7	9	8	12	11	9	23	9	7	10	6	112
8	Detektimi rrjedhjeve me pajisje - Mitrovicë	10	6	4	2	5	3	0	6	5	7	3	15	66
9	Detektimi i rrjedhjeve në mënyrë vizuale - Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	1	0	0	2	0	0	3
10	Të riparuar - Nj.operative-Mitrovicë	50	53	51	34	61	17	41	41	67	75	91	60	69
11	Evidentimi i kons.në GIS	18	40	40	20	30	31	39	103	65	63	72	71	592

Gjendja në fund të vitit pas fillimit të regjistrimit është pasqyruar në tabelën në vijim.

Tabela 20. Përditësimi i të dhënave në GIS

Përshkrimi	Gjendja aktuale
Nr. i konsumatorëve në sistemin e faturimit	47,330
Nr. Konsumatorëve në GIS/EDAMS	44,139
Diferenca mes Faturimit - GIS	3,191
Nr. I konsumatorëve që kanë nevojë për Verifikim-GIS	839
Konsumatorë:	91,2%
Nr. i burimeve të ujit/marrjes - GIS	1
Rrjeti primar dhe sekondar	100%
Nr. i FPU- GIS	3
Nr. i Rezervuarëve - GIS	60
Stacioneve të Pompimit - GIS	36
Nr. i Valvuleve operuese -GIS	814

Nr. i Valvulave të ajrimit -GIS	48
Nr. Valvulave për reduktimit të shtypjes - GIS	14
Nr. ujëmatësve zonal- GIS	125
Hidrant -GIS	60
Defektet -GIS	525
Pompa-GIS	80
Ujëmatësit në prodhim - GIS	5

## 2.6 SHËRBIMI KOMERCIAL

### 2.6.1 Aktivitetet kryesore

Gjatë vitit 2023 shërbimi komercial ka ndërmarrë aktivitete të shumta me qëllim të përmirësimit të performancës së kompanisë dhe rritjen e efikasitetit të punës.

Nga aktivitetet e ndërmarra po veçojmë aktivitetet lidhur me përditësimin e bazës së të dhënave dhe ngritjen e performancës, përmes identifikimit të;

- Konsumatorëve ilegal,
- Konsumatorëve të paidentifikuar,
- Konsumatorëve që në bazën e të dhënave udhëhiqen me ujëmatës, e në fakt nuk kanë ujëmatës,
- Konsumatorëve që janë të regjistruar dy herë për të njëjtën pronë,
- Konsumatorëve që keqpërdorin ujin qoftë me lidhje jashtë ujëmatësi apo edhe shtëpi të kyçura pa lejen e Kompanisë,
- Shtëpive të braktisura/ rrënuara,
- Ujëmatësve të prishur apo të palexueshëm,
- Lidhje të kontratave të Shërbimit dhe ri programimit,
- Inicimi dhe dërgimi i lëndëve në Përmbarim,
- Ankesa dhe Kërkesa të Konsumatorëve.

Me rastin e kontrollit në teren janë identifikuar konsumatorë ilegal që janë kyçur pa lejen e kompanisë dhe janë në procedurë të dërgimit të lëndëve në gjykatë sipas dinamikës së identifikimit nga ekipet e kontrollit dhe faturimit sipas rregulloreve të Autoritetit Rregullator për Ujëra u faturohet 343m<sup>3</sup> dhe legalizohen pas pagesës së taksës së legalizimit.

Spektori i Shitjes me ekipet inspektuese në terren kanë ndikuar direkt në rritje të faturimit duke aplikuar vendimin e ARRU-së për të gjitha kategoritë e konsumatorëve te cil

ët kanë keqpërdorur furnizimin në forma të ndryshme.

Bazuar në të gjeturat e inspektimeve në zonën tonë të operimit kemi identifikuar konsumatorë ilegal si vijon:

- Mitrovicë; 139 konsumatorë ilegal
- Vushtrri ; 56 konsumatorë ilegal
- Skenderaj; 10 konsumatorë ilegal

Të gjeturat më lartë janë si rezultat i bashkëpunimit me sektorin e lexuesve në tre njësit operative; Mitrovicë, Vushtrri dhe Skënderaj. Të gjithë konsumatorët e raportuar me lartë janë raportuar ne zyrën ligjore për hapa të mëtutjeshëm për inicimin e lëndës për dëmtim të pronës publike. Si rezultat i punës në terren ekipet inspektuese kanë vizituar mbi 15.000 konsumatorë për verifikime si dhe pagesa.

Aktivitete janë ndërmarr edhe për lidhjen e Kontratave të Shërbimit, dhe kontratave të ri programimit për borxhet e konsumatorëve. Kontratat e shërbimit me konsumator të nënshkuara janë 7,477. Ndërsa janë nënshkruar 2036 kontrata te ri programimit te borxhit në vlere prej 466,407.12€.

Në formë tabelore janë të paraqitur indikatorët e performancës për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022.

Tabela 21. Indikatorët kyç të performancës

Përshkrimi	2023	2022	Rritja në %
Inkasimi €	4,743,307	3,691,582	28.48
Faturimi m3	12,673,406	12,896,070	-1.72
Faturimi €	5,425,827	5,502,328	-1.39
Numri i pagesave	189,474	167,665	13
Nr. Konsumatorëve	49,729	47,822	3.98

Nga tabela shihet se kemi pasur rritje të konsiderueshme të inkasimit e cila ka ardhur si pasoj e ndërmarrjes së aktiviteteve shtesë në drejtim të shpërndarjes së vërejtjeve, riprogramimit të borxheve të vjetra si dhe aksionet intensive të ekipeve të verifikimit dhe kontrollës në tërë rajonin.

Nga ana tjetër faturimi në sasi dhe në vlerë monetar ishte pothuajse i njëjtë me vitin paraprak po me një rënie të lehtë e cila ka ardhur si rezultat i monitmit të ujëmatësve tek konsumatorët paushal.

Po ashtu kemi pasur rritje tek numri i pagesave dhe numri i konsumatorëve e cila ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të përgjithshëm të konsumatorëve.

Tabela 22. Të dhë mbi konsumatorët paushall dhe kontratat e shërbimit dhe riprogramimit

Përshkrimi	2,022	2,023
Konsumator paushall	2,818	1,906
Kontrata riprogramimi	693	2,024
Kontrata shërbimi	5,111	7,476

## 2.7 INFORMIMI RAPORTIMI & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Zyra për Informim, Raportim & Marrëdhënie me Publikun gjatë vitit 2023 ishte e fokusuar në ngritjen e cilësisë së informimit të publikut dhe me këtë edhe ngritjen e imazhit të kompanisë, raportimit të saktë dhe të drejt si dhe thellimit dhe mirëmbajtjes së raporteve të mira me publikun.

Përkushtimi ynë edhe gjatë këtij viti ishte i fokusuar në informimin sa më të saktë, shpejt dhe të drejt të konsumatorit në veçanti dhe të publikut në tërësi.

### 2.7.1 Informimi

Synim parësor i Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” Sh. A. mbetet informimi i rregullt i qytetarëve mbi punën dhe aktivitetet e përditshme, të cilat lidhen me shërbimet e ujësjetllësit. Angazhimi ynë synon që qytetarëve dhe publikut të regjionit të Mitrovicës t’i prezantohen informatat në kohë reale.

Përmes informimit të drejtë dhe me kohë të qytetarëve mbi punën tonë janë zgjeruar mundësitë për thellimin e komunikimit, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit si me qytetarët/konsumatorët tanë, po ashtu edhe me institucionet tjera komunale.

Informimi bëhet në bazë ditore 24/7 dhe përfshin komunikimin e drejtpërdrejt, përmes telefonit, emailit, facebook –ut, etj.

### 2.7.2 Komunikimi online dhe platforma sociale

Burim kryesor i informatës së KRU “Mitrovica” Sh. A. është ueb faqja zyrtare, platforma sociale Facebook dhe e-maili zyrtar “info@kru-mitrovica.com.

Ueb faqja jonë <http://www.kru-mitrovica.com> ofron informata të shumta mbi strukturën organizative, dokumentet, rregulloret, raportet, konkurset, projektet dhe shumë informata tjera të rëndësishme për publikun të cilat në vazhdimësi përditësohen dhe të njëjtat përkujnë edhe me politikën e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Përveç faqes zyrtare në internet, ujësjellësi "Mitrovica" Sh. A. është i pranishëm me llogarinë në platformën sociale - Facebook <https://www.facebook.com/krumitrovica> ku ka një numër të konsiderueshëm ndjekësish (mbi 10.5K), i cili në vazhdimësi ofron informacione mbi ngjarjet dhe aktivitetet e ujësjellësit. Përmes kësaj platforme qytetarëve u ofrohen informacione në baza ditore për punën dhe zhvillimet për dhe rreth ujësjellësit.

Përmes emailit zyrtar, palët e interesuara drejtojnë kërkesat, ankesat apo shqetësimet e tyre në lidhje me temat respektive. Kërkesat drejtohen tek njësit apo personat përgjegjës dhe përgjigjet ndaj kërkesave të tyre kthehen në afate optimale.

### 2.7.3 Promovimi dhe marketingu

Puna jonë pasqyrohet përmes aktiviteteve të ndryshme të cilat zhvillohen në komunitet: Mitrovicë, Vushtri dhe Skenderaj. Ndër aktivitetet kryesore të cilat janë organizuar gjatë vitit 2023 janë:

- Fushata informuese/vetëdijësuese në lidhje me kursimin e ujit të pijes, cilësinë e ujit të pijes, rëndësinë e ujit për shëndetin e popullatës, pagesën e faturave për shërbime të ujësjellësit etj.
- Takime të drejtpërdrejta me grupe të ndryshme të interesit: fëmijët, nxënësit e shkollave, përfaqësuesit e lagjeve, fshatrave, përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore,
- Shënimi i 22 marsit "Ditës Botërore e Ujit",
- Vizita informuese dhe studimore në Impiantet për Trajtimin e Ujit dhe Ujërave të Ndotura,
- Organizimi i konferencave me gazetarë,
- Intervista për medime lokale e qendrore etj.

### 2.7.4 Trajnimi, puna praktike dhe punësimi

Një pjesë tjetër e rëndësishme e angazhimit tonë ka të bëjë me ofrimin e mundësisë së aftësisë & zhvillimit profesional dhe ngritjes në karrierë si të stafit të brendshëm të kompanisë, po ashtu edhe atyre nga jashtë; nxënës, student dhe të posa diplomuar.

Në këtë aspekt po përmendim disa nga mundësitë e ofruara nga ujësjellësi:

- Organizimi i trajnimeve si brenda, po ashtu edhe jashtë kompanisë për stafin e brendshëm,
- Kryerja e punës praktike të nxënësve nga shkollat profesionale,
- Punësimi për punë praktike (me pagesë të rregullt mujore) të studentëve të drejtimeve të ndryshme: Jurist, Ekonomist, Hidro, IT etj.

### 2.7.5 3.6.4 Raportimi

Një pjesë e rëndësishme e funksionimit të mirë të kompanisë është edhe raportimi. Në këtë drejtim kemi punuar në pasqyrimin e drejt, të saktë dhe në kohë të raporteve mujore, tremujore, vjetore si dhe përgatitjen e Planit të Biznesit për vitet 2024 -2026.

Përgatitja e raporteve fillon nga poshtë – lartë dhe në të marrin pjesë të gjithë sektorët e kompanisë; sektori administrativ, sektori financiar, sektori komercial dhe ai teknik.

Të gjitha raportet vlerësohen dhe miratohen nga ana e Bordit të Drejtorëve.

## 2.8 SHPENZIMET KAPITALE - PROJEKTET

### *Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN)*

Në vazhdim po paraqesim kronologjinë e shkurtër të zhvillimeve dhe aktiviteteve rreth projektit, Ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN).

Tabela 23. Të dhënat mbi projektin

Projekti:	ID e Projektit: 50458 "Ndërtimi ITUN Mitrovicë - Vushtrri
Implementues:	Kompania Regjionale Ujësjetësi -Mitrovicë
PA Lokacioni:	Mitrovicë, Kosovë
Datë:	Janar Dhjetor 2023

<https://ecep.ebrd.com/>

Project: [Mitrovica Eastwater Development Project](#)

Procurement Exercise: [Project Implementation Consultant - Wastewater](#)

ECEPP ID: 15306482

Kapaciteti: 123,000 P/E

Financuar nga: EBRD: 19,800,000 €

EIB: 13,500,000 €

Grant nga: WBIF: 5,000,000 €

	Data
Përshkrimi	
Nënshkrimi i kontratës	23. 03. 2023
Shuma e kontratës	995.200€
Data e hyrjes në fuqi	23.05. 2023
Kohëzgjatja e kontratës	51 Muaj
Data e përfundimit	23 .08.2027
Kapaciteti i ITUN	123,000 P/E

- Zona e Shërbimit; Mitrovicë – Vushtrri
- Kapaciteti

Impianti për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet përreth 123 mijë banorë. Do të trajtojë rreth 230 l/s ujëra të ndotura. Do të përfitohet rreth 7.4 t/d llum. Rreth 95 km instalim i rrjetit të ri

- Përdorimi i Llumit

Mund t'i ndahet bujqve, Mund të shfrytëzohet për mbulimin e deponisë së mbeturinave, Mund të digjet (incinerim) në ITUZ-in e ri në Prishtinë, Apo edhe të Ndërtohet një CHP në Mitrovicë. (për përfitimin e gasit – energjisë elektrike)

- Teknologjia SBR – Përparësitë

Nuk kërkon sipërfaqe të madhe të tokës. Lehtë avancohet për largimin e nutrientëve (Ujërave sensitive) lehtë mund të inkorporohen Veriu i Mitrovicës, Zveçani etj.

- Aktivitetet e përfunduara gjatë vitit 2023

- Përzgjedhja e Konsulencës, Mars 2023
- Aprovimi i Draft Raportit Preliminar për Impiant të Trajtimit të Ujërave të Ndotura
- Aprovimi i Draft Raportit Preliminar për Rrjet të Kanalizimit
- Trajnimi i Njësisë për Implementim të Projektit PIU me temën - Furnizim dhe Prokurim

- Statusi aktual:

a) Hapja e Ftesës për Tender FOPIP- Po punohet në harmonizimit të dokumenteve për tender “Programi për Përmirësimin e Performancës Financiare dhe Operative PPPFP - (FOPIP)”

Projekti ITUN Mitrovica ende nuk ka pasur implikime financiare.

### Vërejtje:

Vështirësi në Procesin e Shpronësimit të Lokacionit për ITUN.

## **2.9 RAPORT I SHËRBIMIT ADMINISTRATIV**

### *2.9.1 Përmbledhje*

Departamenti i Administratës gjatë vitit raportues fillimisht ka siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve me të gjitha departamentet e kompanisë duke filluar nga puna me Bordin e Drejtorëve, Zyrtarët e Kompanisë e deri të udhëheqësit e sektorëve të kompanisë.

Aktivitetet kryesore të departamentit të administratës kishin të bënin me organizimin e aktiviteteve si:

- Organizimi i mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit,



- Përpilimi i procesverbaleve, agjendave, raporteve etj.,
- Shpërndarja e materialeve dhe dokumenteve tjera zyrtare,
- Përpilimin dhe ndarjen e kontratave të reja të punës, vendime, si dhe të gjitha llojet e të aktvendimeve të ndryshme përfshirë, autorizime, urdhëresa dhe vërtetime , nga fusha e marrëdhënies së punës , përgatitja dhe ekzekutimi i pagave , përditësimi i të dhënave të punëtorëve, publikimi i konkurseve, raporte të ndryshme për nevoja të kompanisë , përpunimi i të dhënave për ditët e shfrytëzuara të pushimit vjetor/mjekësor etj.

Është punuar në pranimin, protokollimin dhe arkivimin e dokumente të brendshme dhe jashtme dhe procedimin e tyre tek organet respektivisht personat përgjegjës.

#### 2.9.2 Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2023 ka pasur lëvizje të ndryshme të punonjësve; dalja në pension, ndërprerja e kontratave të punës, skadimi i kontratës së punës, dorëheqje nga vendi i punës etj. Detajet e tilla i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 24. Lëvizja e punonjësve gjatë vitit 2023

Përshkrimi	Meshkuj	Femra	Total
Numri i të punësuarve të rinjë gjatë vitit 2023	10	1	11
Numri i të punësuarvë që u është ndërprerë kontrata e punë gjatë vitit 2023 ( përmes procedurave disiplinore )	4	0	4
Numri i të punësuarve që u është ndërprerë kontrata për shkak të dorëheqjes	4	0	4
Numri i të punësuarve që i është shkëputur kontrata me rastin e pensionimit apo vdekjes	10	0	10

Nga ana tjetër po paraqesim strukturën profesionale të stafit të strukturuar në bazë të përkatësisë nacionale dhe nivelit të përgatitjes shkollore.

Tabela 25. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve

Përgatitja profesionale													
Struktura	Master		Baçelor		E mesme/e lartë		Shkolla Filllore		Pakualifikuar		Gjithsej:		Totali :
Nacionale	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M/F
Shqiptar	15	6	25	9	171	10	13	1	8		232	26	258
Serb													
Malazez													
Turq													
Boshnjak							2				2		2
Ashkali									1		1		1
Gjithësej:	15	6	25	9	171	10	15	1	9		235	26	261

Tabela 26. Statistika; Profesionale dhe Gjinore E KRUM –2023 Sipas Njësive

Përgatitjet Profesionale të Punonjësve													
2023	Master		Baçelor		E mesme/e lartë		Shkolla Filllore		i Pakualifikuar		Gjithsej:		Totali
Njësiti	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
Mitrovicë	12	5	14	7	99	7	5		4		134	19	153
Vushtrri	2		7	2	46	2	8	1	2		65	5	70
Skënderaj	1	1	4		26	1	2		3		36	2	38
Gjithësej:	15	6	25	9	171	10	15	1	9		235	26	261

Tabela 27. Të dhënat mbi lëndët përmbartimore

Përshkrimi	Pages borxhi ne kompani	Riprogramim i borxhit	Borxhi i falur si borxhi i vjeter	Pagese uji tek Permbartuesi	Kthimi i shpenzimeve nga Permbartuesi	Lirim nga TVSH 8%	Pagesat nga Kontratat
Janar	875	884	31,049	21,888	4,888	2,300	564
Shkurt	1,820	1,082	29,326	8,889	2,257	2,172	613
Mars	1,020	1,020	27,004	6,236	1,141	2,000	110
Prill	145	145	19,355	8,895	1,969	1,434	3,974
Maj	1,199	-	13,617	10,262	2,241	1,009	3,756
Qershor	2,362	-	16,894	11,436	3,696	1,251	2,121
Korrik	8,082	-	91,290	12,487	1,613	6,762	16,444
Gusht	1,721	-	31,171	13,455	2,684	2,309	5,299
Shtator	2,335	-	28,523	6,932	1,931	2,113	3,291
Tetor	1,295	-	13,899	6,930	1,809	1,030	1,005
Nentor	1,739	-	24,810	4,563	492	1,838	5,912
Dhjetor	2,728	-	36,803	4,124	1,363	2,726	1,226
Totali	25,321	3,131	363,741	116,097	26,084	26,943	44,315

Tabela 28. Të dhënat mbi lëndët sipas muajve

Muaji	Propozime	Përgjigje/Prapësime	Ekzekutime /Lëndë të Përfunduar	Kontrata/ Marrëveshje	Kallezime Penale
Janar	-	-	-	-	-
Shkurt	-	9	57	79	-
Mars	-	11	57	79	-
Prill	74	32	16	31	7
Maj	111	14	15	37	4
Qershor	69	28	13	32	5
Korrik	90	38	76	339	-
Gusht	-	173	23	69	-
Shtator	-	19	23	79	13
Tetor	-	22	74	31	6
Nentor	77	18	31	35	4
Dhjetor	301	16	21	48	-
Total 2023	722	380	406	859	39




Figura 3 Struktura Organizative

## 2.10 PROKURIMI

Tabela 29. Aktivitetet e prokurimit

Numri rendor	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, përfshirë të gjitha taksat	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata
1	Furnizim me reagensa dhe enë laboratorike (Ri tender II).	24.11.2022.	14,900.00	13,500.00	13,500.00	" UNI- LAB " SH.P.K.
2	Furnizim me goma për automjetet e KUR Mitrovica Sh.A	12.12.2022.	8,000.00	6,893.20	2673.05	Eurogoma
3	Furnizim me Klorur Ferrik	13.1.2023.	50,000.00	44,320.80	44121.75	Grami SH.P.K.
4	Furnizimi dhe montimi i sistemit të kamerave në FTU dhe në objektin administrativ të KURM	17.1.2023.	6,500.00	4,834.89	4,834.89	" Matrix IM " SH.P.K.
5	Furnizim me pajisje të klorizimit për fabrikat e trajtimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës dhe në Balinc të Vushtrrisë.	31.1.2023.	40,000.00	36,238.32	36,238.32	DIAMANTI SH.P.K.
6	Sigurimi shëndetësor i stafit të KUR Mitrovica Sh.A	30.1.2023.	48,000.00	37,908.36	35,866.81	KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.
7	Furnizim me printera te centralizuar per Administrat printera+scan (me tonera)	22.2.2023.	5,500.00	3,896.36	3,896.36	RIKON SH.P.K.
8	Mirembajtja e sistemit te faturimit mobil	15.2.2023.	2,500.00	2,496.00	1,656.00	Tretek SH.P.K.
9	Furnizim me Bllokues te valvulave (Ri tender II)	3.4.2023.	1,500.00	999.46	999.46	BUSINESS PRO SH.P.K.
10	Furnizim me ETHERNET SWICH INDUSTRIAL	24.3.2023.	6,500.00	5,900.00	5,900.00	RGB SH.P.K.
11	Furnizim me bateri për ITU-Shipol	29.3.2023.	2,500.00	1,944.00	1,944.00	" INFINITT " SH.P.K.
12	Furnizim me derivate te naftes per automjetet e KUR"Mitrovica"Sh.A	26.4.2023.	30,000.00	880.00	25,070.09	AL-Petrol
13	Kontrolla sistematike shëndetësore e punëtorëve të KUR"Mitrovica"Sh.A	28.4.2023.	1,500.00	1,440.00	1,440.00	Instituti i Mjekësisë së Punës
14	Vlerësimi teknik i objektit të KUR"Mitrovica"Sh.A në Skënderaj (Ri tender II)	25.4.2023.	1,000.00	800.00	800.00	" PMB Global " SH.P.K.
15	Furnizim me kemikale-Klor per perpunimin e ujit të pijshëm	27.4.2023.	70,000.00	59,121.50	59,121.50	Afrim Sadriu B.I.
16	Furnizimi dhe montimi i sistemit të çasjes (AccesControl) në FTU dhe në Administrata të KRUM	24.5.2023.	10,000.00	8,806.50	8,806.50	E CONNECT AL SH.P.K.
17	Furnizimi dhe montimi i Raftëve për Arhivë	5.7.2023.	900.00	774.00	774.00	" INFINITT " SH.P.K.
18	Furnizim me pjesë për nxemje klimatizim	6.7.2023.	990.00	990.00	990.00	B.V. D. ING
19	Pastrimi i dritareve të Objektit të Administrates në Suhodoll	16.5.2023.	3,000.00	2,748.00	1,145.00	NEE-LINE SH.P.K.
20	Furnizim me pajisje per faturim mobil (Ri-tender II)	3.7.2023.	3,600.00	3,998.00	3,998.00	" INFINITT " SH.P.K.
21	Sigurimi i Automjeteve te KRU-Mitrovica Sh.A	11.8.2023.	9,500.00	6,159.21	2595.13	KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A.

22	Furnizim me kuzhinë dhe dyer në objektin e Administratës	3.8.2023.	6,000.00	4,784.75	4,784.75	4ING SH.P.K.
23	Furnizimi dhe montimi i kubëzave të betonit në oborrin e objektit administrativ të KRUM	2.8.2023.	2,100.00	1,629.00	1,629.00	N.N.P. Eënda
24	Furnizimi me pompa per fshatrat Bistricë, Cerajë, Koshtovë.	23.8.2023.	6,000.00	5,700.00	5,700.00	ROA Consulting SH.P.K.
25	Furnizim me Klorur Ferrik	8.8.2023.	50,000.00	42,960.00	32,091.12	Seykos SH.P.K.
26	Furnizim me Pelet	22.9.2023.	2,000.00	1,405.00	1,405.00	GeoGroup Ing SH.P.K.
27	Furnizimi dhe montimi i pompave për fshatrat Lipe, Boletin dhe Zhazhë. Ri tender II	2.10.2023.	60,000.00	46,300.00	0	ROA Consulting SH.P.K.
28	Furnizimi dhe servisimi me aparate kundër Zjarrit	24.10.2023.	3,500.00	2,580.00	0	Murat Abazi B.I.
29	Furnizimi me pompë zhytëse të lymit (lëvizëse)	16.10.2023.	2,000.00	1,234.00	1,234.00	" EJONA " SH.P.K.
30	Furnizim me vajra, antifriz dhe bateri per automjetet e KRU Mitrovica"Sh.A	1.11.2023.	2,500.00	2,378.00	2,378.00	LALITA GROUP SH.P.K.
31	Punimi i murave dekoruese	31.10.2023.	1,000.00	921.00	0	Eng Bau SH.P.K.
32	Auditimi i pasqyrave financiare të KUR"Mitrovica"Sh.A	14.11.2023.	3,000.00	1,876.20	0	Quatra Audit Int L.L.C.
33	Furnizim me material zyrtar	16.11.2023.	9,500.00	9,277.30	0	EUROPRINT GROUP SH.P.K.
34	Furnizim me PC dhe Laptop	24.11.2023.	5,500.00	4,870.00	0	" INFINITT " SH.P.K.
35	Furnizimi dhe montimi me Klima Inverter 12000BTU (Ri tender II).	20.11.2023.	9,900.00	8,970.00	0	" AS Tech " SH.P.K.
		<b>Total:</b>	<b>479,390.00</b>	<b>379,533.85</b>	<b>305,592.73</b>	

## 2.11 Perspektiva për vitin e ardhshëm

Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" operon si ndërmarrje e cila është llogaridhënëse tek Bordi i Drejtorëve, në përputhshmëri me principet e qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve, duke përfshirë Drejtorët Jo-ekzekutiv dhe Drejtorët/Zyrtarët Ekzekutiv, për të gjitha aktivitetet bazë, për një periudhë më afatgjatë (deri në 2026) ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike si në vijim:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit,
- Mbulueshmëria e plotë e konsumatorëve me ujëmatës (objektiv i caktuar edhe nga ARRU),
- Sigurimi i vetë qëndrueshmërisë financiare,
- Furnizimi i rregullt dhe i pandërprerë me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët,
- Promovimin e relacioneve të mira me konsumatorët dhe publikun,
- Krijimin e një ambienti të favorshëm të punës për të gjithë të punësuarit,

- Përbushja e obligimeve që dalin nga deklarata e nivelit të shërbimeve

Ne planifikojmë që qëllimet strategjike afatgjata të lartë-përmendura të i realizojmë duke shfrytëzuar resurset e Kompanisë por dhe përmes mbështetjes nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorëve aktual por dhe atyre potencial. Kompania ka paraparë përbushjen dhe arritjen e objektivave strategjike deri në vitin 2026 si vijon:

- Zvogëlimin e shkallë së ujit të pa faturuar në 45 %
- Pajisja me ujëmatës e konsumatorëve në shkallën prej 100%
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 89 %
- Ngritjen e normës së punës në 1.22
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.39

## **2.12 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)**

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SWOT dhe metodologjinë e katër faktorëve; fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Këta faktorë kanë të bëjnë me rritjen e organizatës, produktet, shërbimet dhe objektivat e biznesit dhe konkurrencën e tregut. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm: përparësitë dhe dobësitë dhe kanë të bëjnë me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj, kurse dy faktorët tjerë: mundësitë dhe rreziqet paraqesin faktorët e jashtëm dhe të njëjtit varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura KRUM do të tentoj që të minimizoj dobësitë dhe rreziqet dhe të maksimizoj përparësitë dhe mundësitë.

### **Përparësitë:**

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit,
- Infrastrukturë të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Treg të sigurt, konsumatorë të besueshëm, shitje të garantuar,
- Mbështetje nga Partnerët si: Qeveria, Komunitat, SHUKOS, ARRU,, BE, CDI dhe donatorët tjerë,
- Mos prezencë e konkurrencës në sektorin operues,
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese; Impianti në Shipol dhe Balinc,

### **Dobësitë:**

- Pajisjet e vjetërsuara dhe jo të përshtatshme me metodat bashkëkohore,
- Moshë e shtyrë e fuqisë punëtore,

- Konsumi i ujit ne veri dhe mos pagesa e tij,
- Humbjet e mëdha teknike dhe komerciale,
- Gjendja e vështire ekonomike dhe niveli i lartë i rasteve sociale në regjionin e Mitrovicës,
- Sistemi Informativ Menaxhues (MIS),
- Borxhet e trashëguara te klientëve

#### Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve,
- Zhvillimin e shërbimeve të reja lehtësuese për konsumatorin,
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit,
- Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit të ujit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave,
- Bazë e mirë ligjore për procedim të lëndëve të ndryshme në Gjykatë apo përmes Përmbaruesve Privat,
- Infrastrukturë ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU),
- Pjesëmarrje në konferenca vendore e rajonale përmes Shoqatës së Ujësjetësve të Kosovës (SHUKOS),
- Ngritja e kapaciteteve profesionale

#### Rreziqet:

- Kriza ekonomike e regjionit si rrjedhoje e papunësisë
- Ngritja e tensioneve sociale apo politike,
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.),
- Shfaqja e ndonjë pandemie të re.
- Trendi i ikjes se fuqisë punëtore

### 3 SHOTJCA 1 : PASQYRAT FINANCIARE

#### K.R.U. MITROVICA SH.A. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Me 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat në Euro

ME 31 DHJETOR		2023	2022
	Shënimi	€	€
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	23,690,792	24,162,675
Investimet në vijim	5a	90,676	90,676
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>23,781,468</b>	<b>24,253,351</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	26,156,905	25,871,367
Stoqet	7	251,509	264,537
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	203,808	32,081
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>26,612,222</b>	<b>26,167,985</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>50,393,690</b>	<b>50,421,336</b>
<b>DETYRIMET DHE EKUITETI</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	4,935,742	5,046,592
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>4,935,742</b>	<b>5,046,592</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet e tjera afatgjata	10	17,927,247	17,900,882
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>17,927,247</b>	<b>17,900,882</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>22,862,990</b>	<b>22,947,473</b>
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	11	26,490,000	26,490,000
Fitimet e mbajtura		1,040,700	983,863
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>27,530,700</b>	<b>27,473,863</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>50,393,690</b>	<b>50,421,336</b>



**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

*Të gjitha shumat në Euro*

	<i>Shënimi</i>	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023</b>	<b>Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022</b>
		<b>€</b>	<b>€</b>
Të hyrat	12	5,026,688	5,139,898
Kostoja e shitjes	13	(738,938)	(659,702)
<b>Fitimi / (humbja) bruto</b>		<b>4,287,750</b>	<b>4,480,196</b>
Të ardhurat tjera	12	1,399,008	1,639,135
Shpenzimet e shpërndarjes	14	(2,589,618)	(2,480,465)
Shpenzimet e personelit	15	(2,212,798)	(1,998,927)
Shpenzimet administrative - Komunalitë	16	(781,609)	(737,272)
Shpenzimet administrative tjera	17	(590,670)	(797,921)
<b>Fitimi / (humbja) operativ</b>		<b>(487,938)</b>	<b>104,745</b>
Shpenzimet financiare	18	(9,044)	(19,157)
Të ardhurat financiare			
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>(496,982)</b>	<b>85,589</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
<b>Fitimi / (humbja) i/e vitit</b>		<b>(496,982)</b>	<b>85,589</b>

**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
Të gjitha shumat Euro

	<b>Kapitali aksionar €</b>	<b>Fitimet e mbajtura €</b>	<b>Gjithsej €</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2022</b>	<b>26,490,000</b>	<b>898,274</b>	<b>27,388,274</b>
Fitimi / (humbja) i/e vitit		85,589	85,589
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>26,490,000</b>	<b>983,863</b>	<b>27,473,863</b>
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(496,982)	(496,982)
Ndryshimi ne vitet e kaluara		553,819	553,819
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>26,490,000</b>	<b>1,040,700</b>	<b>27,530,700</b>

**K.U.R. MITROVICA SH.A.**  
**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**  
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023  
Të gjitha shumat Euro

<b>Pershkrimi</b>	<b>2023</b> €	<b>2022</b> €
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(496,982)	85,589
<b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	2,471,861	2,375,183
Shpenzimet financiare	9,044	19,157
	<b>1,983,923</b>	<b>2,479,928</b>
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(285,538)	(1,087,470)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	13,028	(7,318)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(110,850)	(176,647)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	26,367	(1,255,555)
	<b>(356,993)</b>	<b>(2,526,990)</b>
Interesi i paguar	(9,044)	(19,157)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>(9,044)</b>	<b>(19,157)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(1,999,978)	(6,215)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(1,999,978)</b>	<b>(6,215)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Ndryshimi në vitet e kaluara	553,819	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>553,819</b>	<b>-</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>171,727</b>	<b>(72,433)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	32,081	104,514
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>203,808</b>	<b>32,081</b>

## 4 SHTOJCA 2: RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM

---

### 4.1 Auditimi i brendshëm

Raporti në vijim paraqet një rekapitullim të punës dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm në KRU Mitrovica, për periudhën Janar – Dhjetor 2023. Përmes këtij raporti prezantohet niveli i realizimit të caqeve të përcaktuara me plan vjetor të punës për vitin aktual.

Fillimisht duhet të theksohet se të gjitha aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe raportuese, e që kanë të bëjnë me fushën e auditimit, janë zhvilluar në pajtim me planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm për vitin 2023, si dhe në bazë të kërkesave shtesë nga ana e Komisionit të Auditimit.

Objektivë kryesore e këtyre auditimeve ka qenë:

- Rishikimi i funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, të dizajnuara nga menaxhmenti;
- Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset janë kryer në pajtueshmëri me ligjet aplikative dhe aktet tjera të brendshme;
- Sigurimi i menaxhmentit të kompanisë që proceset e realizuara janë të një performance të duhur duke përbushur disa nga kriteret në aspektin ekonomik, atë të efikasitetit dhe të efektivitetit;
- Nxjerrja e rekomandimeve praktike për përmirësime aty ku është e nevojshme, si dhe
- Rishikimi i rekomandimeve dhe niveli i përmbushjes apo implementimit të tyre.

Në pajtim me legjislacionin aktual në fuqi, standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe planit vjetor të punës së auditimit të brendshëm, gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, janë realizuar këto aktivitete:

- Raporti vjetor i punës së auditorit të brendshëm për vitin 2022;
- Plani strategjik i punës së auditorit të brendshëm për periudhën kohore trevjeçare 2024 – 2026;

Duhet theksuar se gjatë vitit 2023 janë realizuar gjithsej 10 auditime. Prej tyre të planifikuara me plan vjetor 2023 kanë qenë 6 auditime, ndërsa 4 auditim shtesë është kryer me kërkesë.

Bazuar në planin vjetor të auditimit, si dhe kërkesave të Komisionit të Auditimit fushëveprimi i auditimit ka qenë:

1. Faljet e Borxheve 2022;
2. Furnizimi i Ujit nga Ibër - Lepenci;
3. Furnizimi dhe Shpenzimi i Kimikaleve 2022;
4. Raporti i Kontrollës;
5. Konkursi për Drejtor Komercial;
6. Menaxhimi i Pasurisë;
7. Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe të makinerisë;
8. Menaxhimi i Faturimit dhe i Konsumatorëve;
9. Verifikimi i prodhimit dhe i humbjeve të ujit;
10. Menaxhimi i Prokurimit;

Duhet theksuar, se gjatë auditimit të disa fushave dhe proceseve, normalisht se janë vërejtur dhe konstatuar disa mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime për tu përmirësuar.

Gjatë rishikimit të adresimeve të rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës audituese vjetore, të paraqitura në vijim të raportit, është konstatuar se nga 59 rekomandimet e dhëna, 25 prej tyre janë realizuar, 22 janë në proces të realizimit, ndërsa 12 janë të pa implementuara

Falë bashkëpunimit të mirë me udhëheqësit e subjekteve audituese dhe stafit në përgjithësi, si dhe falë përkushtimit, përkrahjes dhe qasjes konstruktive dhe profesionale të Bordit dhe Komisionit të Auditimit, konsideroj se planifikimi, realizimi i detyrave dhe i përgjegjësi, si dhe aktiviteteteve tjera të auditorit të brendshëm gjatë vitit 2023 kanë qenë e përmbushur dhe e një niveli të duhur.

